



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



DREJTORIA E ARSIMIT

NJOFTIM PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Të nderuar kandidatë,

Komisionet përkatëse të Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) të Komunës së Prishtinës, të premtën, më 27 tetor 2014 e kanë bërë përzgjedhjen e 3 kandidatëve për intervistim, (me përjashtim të disa pozitave ku nuk është e paraparë me normativ, për këtë mbetet të vendoset në ditët në vijim) që kanë aplikuar sipas konkursit të muajit shtator 2014.

Përzgjedhja është bërë në monitorimin e shoqërisë civile dhe sipas procedurës së përzgjedhjes, kriteretë paraseleksionimit dhe udhëzimeve administrative përkatëse, dokumente të cilat tashmë kanë qenë publike për të gjithë kandidatët, por janë në dispozicion të të gjithë kandidatëve edhe këtu në ueb faqe.

Për të qenë plotësisht transparent, ne po e publikojmë edhe databazën e kandidatëve, në mënyrë që secili mund ta shoh se kush është përzgjedhur për intervistim e kush jo. Është vetëm një databazë. Databaza i ka të dhënat për kandidatët që kanë aplikuar në pozitat prej 1 - 33 sipas konkursit të shpallur. Po ashtu, ka pasur disa kandidatë që nuk kanë dëshmuar notën mesatare, prandaj në mungesë të të dhënave, piket e pakonfirmuara për notë mesatare, nuk mund të evidentohen.

Për secilën pozitë (kodi i pozitës sipas konkursit) të dhënat gjenden në databaza (në sheets sipas kodit).

- Fillimisht janë marrë në konsideratë vetëm kandidatët e rangut të parë sipas Udhëzimit Administrativ(UA) 09/2014 dhe nëse ka pasur kandidatë të mjaftueshëm të kësaj kategorie, atëherë kandidatët e rangut tjetër nuk kanë ardhur në shqyrtim.

- Kandidatët që kanë pasur më shumë vite të studimeve dhe ECTS kredi, janë marrë parasysh para kandidatëve të tjerë. - Kandidatët e përzgjedhur për intervistim janë kandidatët e parë, rreshtat e të cilëve janë hijezuar fund e krye me ngjyrë të kuqe.

- Kandidatët që janë të hijezuar fund e krye me ngjyrë të kaltër janë kandidatë që janë përzgjedhur për t'u intervistuar në ndonjë pozitë tjetër, meqë kanë aplikuar në më shumë se një pozitë, në ndërkohë që mund të ftohet në vetëm një vend/pozitë për intervistim.

Faqe 1 nga 2

- Kandidatët që janë të hijezuar me ngjyrë të kuqe vetëm në kolonën K, janë kandidatë që kanë qenë të kualifikuar si kandidatë të rangut të parë sipas udhëzimit administrativ 09/2014, por të cilët nuk kanë arritur të përzgjidhen për intervistim, meqë sipas kritereve të paraseleksionimit janë përzgjedhur 3 kandidatët që kanë marrë më së shumti pikë.

Për të ruajtur konfidencialitetin e kandidatëve, nëpër databaza janë vetëm emrat e mbiemrat e kandidatëve që janë përzgjedhur për intervistim, ndërsa për kandidatët e tjerë janë vetëm numrat e protokollit, në mënyrë që secili të mund t'i shoh pikët e tij/saj në ndërkohë që të tjerët nuk mund ta dijnë identitetin e tyre.

Kandidatët e përzgjedhur për intervistim së shpejti janë kontaktuar ose do të kontaktohen nga komisionet përkatëse për t'u informuar me detajet e intervistimit (vendi, dita, data dhe koha e intervistimit).

Ne jemi të vetëdijshëm që gjatë futjes së të dhënave në databazë mund të jenë bërë gabime, dhe kjo është njerëzore, prandaj i inkurajojmë kandidatët që vërejnë se ka pasur ndonjë gabim le të na shkruajnë, në mënyrë që ne të ndërmarrim hapat e nevojshëm për të bërë korrigjimet e duhura.

Kushdo që konsideron së është bërë ndonjë gabim ose i është bërë padrejtësi mund të ushtrojë ankesë me shkrim ne afat prej tri (3) ditëve në DKA (vetëm me shkrim – jo takim) dhe DKA-ja do të kthejë përgjigje brenda afatit ligjor.

Në rast se pas ankesave tuaja, verifikohet se ka pasur lëshime teknike, të njëjtit do të ftohen në intervistë. Prandaj, edhe data-baza me përmirësime do të publikohet pas shqyrtimit të ankesave.

Sidoqoftë, para se të ushtroni ankesë ju lusim që paraprakisht t'i lexoni me vëmendje këto sqarime dhe të gjitha dokumentet që janë të publikuara ne web-faqe.